

Në mbështetje të nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nr. 05/L-031) si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MFPT) nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale Mitrovica Sh.A në Mitrovicë me datë 04.09.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Anulohen Konkursët e publikuara në ueb faqen zyrtare të kompanisë, si dhe në portalet elektronike të datës **30.06.2025** si dhe Konkursët e datës **30.07.2025**, për plotësimin e vendeve të lira të punës.

A r s y e t i m

Gjatë rishikimit të dokumentacionit dhe procesit të shpalljes së konkurseve janë vërejtur lëshime teknike në përkthimin e kriterëve të konkursit, duke cenuar të drejtën për aplikim të barabartë.

Janë identifikuar gjithashtu paqartësi lidhur me kërkesat minimale arsimore, trajtimin e diplomave të fituara para dhe pas korrikut 1999, si dhe atyre të lëshuara nga institucione arsimore në gjuhën serbe brenda territorit të Kosovës, përfshirë nevojën për nostrifikim apo verifikim të tyre.

Me qëllim të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë kandidatët, sigurimit të sqarimeve të nevojshme dhe udhëzimeve të qarta, konkursët aktuale anulohen dhe do të rishpallen brenda një afati të arsyeshëm.

Obligohen Burimet Njerëzore të KRU “Mitrovica” Sh.A. me zbatimin e këtij vendimi duke njoftuar të gjithë kandidatët.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe publikohet në uebfaqen e kompanisë.

Vendimi i dërgohet:

1 x arhives

1x burimeve njerzore


Kryeshefi Ekzekutiv

Bashkim Kurti